

# Android TV™ Manual Udhëzimi

Me lidhjen e TV pajisjes suaj me internet ju mundësohet që të shkarkoni aplikacione dhe lojëra dhe të përdorni shërbimet në internet, njëlloj sikur me telefona ose tablete. Manuali sqaron si të rregulloni TV pajisjen tuaj për të përdorur këto opsione.

Mund mos të përdorni këtë opsion nëse preferoni të shikoni vetëm TV programe të rëndomte.



(Të gjitha menyët dhe ilustrimet janë vetëm në gjuhën angleze.)

(Ruani këtë manual me udhëzimet për referencë në të ardhshmen.)

### Shkarkimi i aplikacioneve dhe lojërave

1. Lidhja e TV pajisjes me internet ..... 2
2. Kycja në llogarinë Google™ me TV pajisjen ..... 5
3. Shkarkimi i aplikacioneve dhe lojërave nga Google Play™ store ..... 7

### Përdorimi i internet shërbimeve të Sony

4. Përdorimi i internet shërbimeve të Sony ..... 8


# 1 Lidhja e TV pajisjes me internet

Njëherë, duhet të lidhni TV pajisjen tuaj me internet me atë të wireless (Wi-Fi) ose lidhje me tel. Ju duhet edhe internet funksional: për detaje, konsultoni provajderin e internetit. Kërceni këtë hap nëse TV pajisja juaj vetëm më është lidhur me internet.

Për të kontrolluar statusin e lidhjes së internetit dhe rregullimet si MAC adresa, zgjidh [Help] në fund të menysë Home, dhe pastaj zgjidhni [View network status].


## Lidhja me internet pa tel (wireless (me Wi-Fi))

1 Shtyp HOME butonin ne telekomande për të shfaqur Home Menu.



\*Telekomandë me prekje nuk jepet me gjitha modelet.

2 Në Home Menu, lëvizni fokusin në fund të ekranit, dhe zgjidhni [Network Settings] — [Wi-Fi].



3 Zgjidhni hapat e rregullimit për ruterin wireless:


A mbështet ruteri juaj WPS (Wi-Fi Protected Setup)?

Po

Përdorni WPS butonin për të lidhur

① Zgjidh [Connect via WPS] nga menya.

② Shtypni WPS butonin në ruterin tuaj.




Jo, ose pasigurt

Zgjidhni SSID manualisht.

① Zgjidhni SSID të ruterit nga menya.


SSID është numri i identifikimit të ruterit tuaj. Mund të gjeni SSID dhe fjalëkalimin (kodin e sigurimit) në etiketë që gjendet në ruterin tuaj. Për më shumë detaje, shikoni manualin e ruterit tuaj.



② Shënoni fjalëkalimin e ruterit.

## Lidhja me internet me anë të LAN kordonit (të rrjetit)

1 Lidhni LAN kordonin me LAN portin mbrapa TV pajisjes.



TV pajisja automatikisht do të lidhet me internet brenda 30 sekondave.

Nëse TV pajisja nuk lidhjet me internet automatikisht. TV pajisja mund mos të lidhet me internet automatikisht varësisht nga rregullimet e ruterit. Zgjidh [Network Settings] në fund të Home Menu për të rregulluar rrjetin manualisht.



Kërceni këtë hap nëse vetëm më jeni lidhur me llogarinë Google me TV pajisjen gjatë rregullimit fillestar.

Llogaria Google ju jep qasje në shërbime të ndryshme të Google. Nëse vetëm më keni krijuar llogari Google me anë të kompjuterit ose telefonit, mund të përdorni atë llogari për të lidhur.

## Krijimi i llogarisë Google

Google llogaria nuk mund të krijohet me anë të TV pajisjes. Përdorni kompjuter ose telefon për të krijuar llogarinë.

- 1 Vizitoni ueb faqen më poshtme me kompjuter ose telefon:  
<http://accounts.google.com/signup>




- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të krijuar llogarinë Google.

### Mund të krijoni llogari Google gjatë rregullimit fillestar të TV pajisjes.


- ① Lidhni TV pajisjen tuaj gjatë rregullimit fillestar.
- ② Në [Sign in to Google] menyne e rregullimit fillestar, zgjidh [Use your phone or laptop].
- ③ Përdorni kompjuter ose telefon për të vizituar lidhjen me poshtë dhe ndiqni udhëzimet në ekran për të krijuar llogarinë Google.  
[g.co/AndroidTV](http://g.co/AndroidTV)

## Kyçja në llogarinë Google me TV pajisjen tuaj

- 1 Zgjidh [Google Play Store] në [Apps] në Home Menu.



- 2 Pasi që të paraqitet menya për të kyçur, ndiqni udhëzimet në ekran për të kyçur.



Pasi të kyçeni dhe shtypni HOME butonin në telekomandën tuaj, ju shfaqen rekomandimet në Home Menu.



Menya për kyçje me llogarinë Google paraqet edhe kur të lidheni me internet gjatë rregullimit fillestar ose kur do të niseni ndonjë aplikacion.

### Për të çlidhur


Zgjidh [Personal] në [Settings] në Home Menu, pastaj fshini llogarinë tuaj nga TV pajisja.

## Google Play™ store

Mund të shkarkoni aplikacione dhe lojëra nga Google Play store në TV pajisjen njëjloj sikur me telefona ose tablete.

Mund të shkarkoni vetëm aplikacione dhe lojëra që janë kompatible me TV pajisjen. Mund të jenë më të ndryshme nga ato për telefona ose tablete.

- 1 Zgjidh [Google Play Store] në [Apps] të Home Menu.



- 2 Zgjidh aplikacionin ose lojën që doni të shkarkoni dhe instalojeni. Aplikacioni do të fillojë të shkarkohet.

Pasi të shkarkoni, aplikacioni automatikisht instalohet. Ikona e saj paraqitet në Home Menu, që ju mundëson të nisni.

### Mbi aplikacionet me pagesë

Ka aplikacionet falas dhe me pagesë në Google Play store. Për të blerë një aplikacion, një kod nga kartela dhuratë ose kartelë kredie duhet të përdorni. Mund të blini kartelë dhurate nga shitës të ndryshëm.

### Të fshini një aplikacion

- ① Zgjidh [Google Play Store] në [Apps] të Home Menu.
- ② Zgjidh aplikacionin për të fshirë dhe çinstaloni aplikacionin.

## 4 Përdorimi i internet shërbimeve të Sony

Me lidhje me internet dhe kyçje në internet shërbimet e Sony, mund të përdorni shërbime të ndryshme siç janë video shërbimet dhe muzikën në internet.

Për të përdorur këto shërbime, ju nevojitet SEN llogari.

Këto shërbime duhet të jenë në dispozicion pas përditësimit të softuerit në pranverë të vitit 2015.

## Krijimi i SEN llogarisë

SEN llogaria nuk mund të krijohet me anë të TV pajisjes. Përdorni kompjuter ose telefon për të krijuar llogarinë.


- 1 Vizitoni ueb faqen me anë të kompjuterit ose telefonit:  
<https://account.sonyentertainmentnetwork.com>

- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të krijuar SEN llogarinë.

## Lidhja me TV pajisjen me anë të SEN llogarisë

- 1 Zgjidhni ikonën e internet shërbimit të Sony në Home Menu.

- 2 Pasi që të paraqitet menya për kyçje, ndiqni udhëzimet në ekran.



Menya për kyçje me SEN llogari paraqitet edhe kur të lidheni me internet gjatë rregullimit fillestar. Mund të kyçeni edhe nga kjo meny.

• Google, Google Play, Android TV dhe shenjat tjera janë marka tregtare të Google Inc.  
• Disa funksione ose shërbime mund të mos të jenë të gatshme varesisht nga rajoni/shiti.  
• Informacionet në këtë manual mund të ndryshohen pa paralajmërim paraprak.  
• Wi-Fi Protected Setup Identifier Mark është shenjë certifikimi e Wi-Fi Alliance.